



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 12/2009

Më 14. 04. 2009, ora 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Et'hem Çeku, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Fatmir Rexhepi, Mufëra Şinik, Kaqusha Jashari, Sala Berisha - Shala dhe Berim Ramosaj.

Munguan: Slobodan Petroviq, dhe Zef Morina.

Pjesëmarrës të tjerë: Lutfi Zharku, ministër - MTI, Daut Rudi, Ruzhdi Shehu, Remzije Hajdari - MTI, Naip Zeka, Ibush Jonuzi dhe Azem Rexhaj - KPMM, Lejla Selimi - OSBE, Blerina Uka – NDI dhe Ramadan Klisurica - KDI.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 07. 04. 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë;
4. Shqyrtimi i Raportit të KPMM-së për vitin 2008;
5. Të ndryshme.

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 07. 04. 2009

Procesverbali i mbledhjes së 07. 04. 2009 u miratua pa vërejtje.

III. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë

Kryetarja - Përshëndeti pjesëmarrjen e ministrit Zharku dhe ia dha fjalën për t'i paraqitur pikëpamjet e Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë (në vijim MTI) për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë.

Lutfi Zharku - ministër i MTI-së - Në ekspozenë e Ministrisë, për këtë projektligj theksoi se propozimet nga ana e Komisionit janë shqyrtuar në MTI. Parimisht i përkrahu disa nga propozimet, mirëpo kërkoi t'i jepte disa sqarime. Tha të hapet një zyrë me qëllim që këshilli të mbetet si është tash. Për rregullimin dhe vëzhgimin e sektorit të naftës të mbetet një zyrë në kuadër të Ministrisë, në shërbimin civil. Sa i përket Komisionit të ankesave në versionin e tanishëm, nuk kemi bërë ndryshime të mëdha. Nëse do të mbetet këshilli, ministri do të konsiderohej palë, në këtë rast palë ose subjekt i cili aplikon për licencë. Aktualisht nëse një subjekti i refuzohet licenca, ka mundësi të ankohet në një komision tjetër në Ministri. Nëse ministri vëren shkelje nga ana e këshillit, i cili emërohet nga Qeveria, nuk ka kurrfarë kompetencash ta ndalë një licencë ose të intervenojë për të mos e nënshkruar atë. Në rast të mosrespektimit të ligjit, të mos e nënshkruajë dhe ta kthejë. Propozimi që të formohet komisioni i ankesave nga ana e Qeverisë është precedent, meqë nëpër ministri dyshkallësia, në përgjithësi, rregullohet në kuadër të të njëjtit organ. Nëse kemi të bëjmë me një licencë ose me një vendim që jepet në kuadër të Ministrisë, edhe komisioni për ankesa duhet të jetë në kuadër të asaj Ministrie. I përmendi edhe disa komisione të tjera që veprojnë në Ministri, p.sh.: komisionin për licencim të ndërmarrjeve të hoteleve dhe të moteleve, si dhe komisionin për licencim të ndërmarrjeve ndërtimore etj.

Haki Shatri - I paraqiti gjithsej 33 amendamente, të cilat sipas tij shumica janë të natyrës juridike e gjuhësore, që nuk ndikojnë në përmbajtje. I ftoi anëtarët vëmendjen ta përqendrojnë në tri çështje përmbajtjesore: këshilli për licenca (neni 3 i ligjit), komisioni për ankesa (neni 9 i ligjit dhe neni 11 i projektligjit), si dhe autoriteti që do t'i shqiptojë masat ndëshkimore (neni 14 i ligjit dhe neni 17 i projektligjit). Vuri në pah se sipas sponsoruesit, këshillin për licencim e emëron Qeveria. Ai funksionon sipas kërkesave. Ankesat kundër vendimeve të tij, pala e pakënaqur ka të drejtë t'i paraqesë në komisionin e ankesave, të cilin e emëron ministri. Raportuesi, Haki Shatri, propozoi që këshilli për licenca të bëhet zyrë e përhershme për licencim nga shërbyesit civilë, ngase kjo zyrë ka punë gjithnjë. Për shqyrtimin e ankesave propozoi të formohet një njësi (komision) ad hoc, sipas rasteve në kuadër të Ministrisë. Kjo njësi për punën e saj paguhet me mëditje.

Me këtë propozim u pajtuan në parim të gjithë anëtarët e Komisionit. Këtë ide e përkrahu edhe ministri i MTI-së. Komisioni autorizoi raportuesin që detyrat dhe procedurat e hollësishme t'i përpunojë me qëllim që të jenë funksionale dhe propozoi të shqyrtohen dhe të miratohen në mbledhjen e radhës. Sa u përket masave ndëshkimore, për të cilat u debatua, edhe sponsoruesi propozoi që shqiptimin e masave ndëshkimore ta bëjë inspektorati. Raportuesi Shatri hamendej se shqiptimi i gjobave, gjer në 150.000 euro, për disa shkelje të dispozitave, është apo nuk është funksional, objektiv dhe i zbatueshëm.

Berim Ramosaj, Fatmir Rexhepi dhe Et'hem Çeku ishin të mendimit se përderisa autorizimet e inspektoratit rregullohen me Ligjin për inspektim edhe kjo çështje duhet të jetë në harmoni me Ligjin për inspektorin e tregut, që është ligj bazë.

Berim Ramosaj - Propozoi që inspektorati të ketë të drejtë ta nisë procedurën në gjykatën kompetente të kundërvajtjeve, që gjatë vlerësimit të shkallës së fajësisë, kur shkelen dispozitat ligjore, ka për detyrë të marrë parasysh edhe rrethana të tjera me ndikim në kundërvajtje.

Safete Hadergjona – Tha se vërejtjet e Komisionit, të paraqitura në mbledhjen e kaluar, do të duhej të merreshin parasysh, sepse ky është një projektligj i natyrës së ndjeshme, që kërkon përkushtim më të madh. Këto vërejtje do t'i paraqesë në mbledhjen e radhës. Po ashtu edhe për disa amendamente të paraqitura kishte rezervë.

Meqenëse anëtarët e tjerë hamendeshin se cili organ do ishte më efikas për parandalimin e shkeljeve të ligjit, u vendos që raportuesi t'i hulumtojë praktikën e rajonit, rrethanat e vendit dhe në mbledhjen e radhës të propozojë zgjidhje përkatëse. Komisioni u pajtua me propozimin për zgjatjen e afatit prej 30 në 60 ditë për paraqitjen e kërkesës për vazhdimin e licencës para afatit të skadimit. Sipas propozuesit afati i paraqitjes, para skadimit, ishte 30 ditë, kurse afati i përgjigjes 60 ditë.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

I. Në mbledhjen e radhës të vazhdojnë shqyrtimi, amendamentimi dhe miratimi i raportit përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë.

II. Njësia Mbështetëse e Komisionit t'i spastrojë dhe t'i sistemojë të gjitha propozimet e miratuara.

IV. Shqyrtimi i Raportit të KPMM-së për vitin 2008

Kryetarja - Tha se në këtë pikë të rendit të ditës do të shqyrtohet Raporti vjetor për vitin 2008 i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (në vijim KPMM) dhe ia dha fjalën z. Naip Zeka, për ta paraqitur Raportin vjetor.

Naip Zeka - kryesues i Bordit të KPMM-së - Në ekspozenë e tij për Raportin vjetor të vitit 2008 tha se deri tani KPMM-ja i ka raportuar PSSP-së. Kjo ishte e drejtë e rezervuar

e UNMIK-ut. Kosovarizimi i Bordit Qeverisës është kryer në fund të vitit 2006 dhe kundrejt të deleguarit ndërkombëtar, nga viti 2007, u bë plotësisht i pavarur në vendimmarrje. Në vitin 2007 kryesisht u përqendrua në korrigjimin e politikave të gabuara e të instaluara nga ndërkombëtarët në qeverisjen e KPMM-së. Mungesa e politikave përkatëse të Qeverisë së Kosovës, që nga Çlirimi (1999 - 2000), për këtë sektor, në shumë raste, ka shkaktuar probleme të konsiderueshme. Sipas problemeve është dashur me MEM-in edhe me ministritë e tjera, të gjenden zgjidhje të drejta, si p.sh.: shpallja e moratoriumit për licenca hulumtimi të mineraleve në mandatin e Qeverisë paraprake, kur z. Çeku ishte ministër në MEM. Kjo praktikë vazhdoi edhe në këtë Qeveri. Me gjithë bashkëpunimin e mirë, ende nuk kanë përfunduar punët e përcaktimit të politikave sektoriale. Njoftoi se ka filluar projekti i ligjit për miniera dhe minerale. Është arritur përparim i madh dhe është afër procedimit për shqyrtim në Komisionin e Kuvendit. Z. Zeka tha se KPMM-ja pret që ndikimi i Komisionit në azhurimin e Qeverisë për përpilim dhe miratim të politikave të sektorit dhe të strategjisë të jetë qenësor, sepse KPMM-ja ka punuar në zbatimin e rreptë të ligjeve dhe ka qenë jashtë ndikimit politik të institucioneve dhe të politikave të UNMIK-ut, më parë dhe të Qeverisë së Kosovës. Tani ky përfundim u fuqizua me deklarinimin se Bordi Qeverisës i KPMM-së është i përbërë nga stafi profesional i fushës së gjeologjisë dhe të xehtarisë, së bashku me stafin menaxhues. Kjo ndihmoi në veprimin e plotë të pavarur të KPMM-së nga ndikimet e politikës ditore. Këtë e vërtetojnë edhe dy auditive, të cilat konfirmuan rregullsinë e plotë me rastin e licencimeve, dhënies së lejeve të veçanta dhe të shfrytëzimit të buxhetit.

Et'hem Çeku – U interesua për dy çështje: A ka skaduar moratoriumi për lëshimin e licencave për minerale metalesh dhe a ka lëshuar KPMM-ja në vitin 2008 licenca për minerale metalesh?

Sala Berisha - Shala - Shtroi një sërë pyetjesh: Në Raport është vërejtur se ka pasur disa aksidente, a ka dhënë ndokush përgjegjësi për ndonjë aksident? Kërkesat për licenca të refuzuara, a janë K2, K3 apo M1? Plani i guroreve të Kosovës, a është duke u zbatuar? Sa janë futur në funksion matjet ajrore gjeofizike? Laboratori Gjeologjik, a është futur në funksion dhe a menaxhohet nga KPMM-ja, apo nga Fakulteti? A është marrë parasysh moratoriumi për lëshimin e licencave për minerale metalesh? Licenca e lëshuar për kompaninë Kosovo Resources LLC në Drazhnje, a është ende valide? A janë duke vazhduar hulumtimet? A është ndërmarrë diçka? Për këtë licencë dihet se kishte probleme kur është dhënë. Sigurisht Trepça ose Qeveria për të do të paraqesin ndonjë padi. Po ashtu për këtë rast Kuvendi, në mandatin e kaluar, ka nxjerrë një rezolutë. Sipas listës së licencave vërehet se Feronikeli ka marrë edhe licenca të tjera. A janë këto në kundërshtim me zonat e shpallura të interesit, sa i përket strategjisë së minierave, që u tha se ende mungon, sepse MEM-i nuk ka mundur të punojë për shkak të mungesës së ligjit të minierave? Në vitin e kaluar ka punuar një grup ndërinstitucional në KPMM lidhur me taniemat. A është miratuar ky propozim? Nëse jo, pse? A ka paguar Feronikeli taniema për mineralet e shfrytëzuara? Nëse ka paguar, për cilin vit ka paguar? Në fund u ndal tek operimet ilegale: Cili rajon në Kosovë ka me shumë operime ilegale? A mos janë këto operime pasojë e vonesave të licencimit nga KPMM-ja? A keni bërë ndonjë vlerësim pse ka kaq shumë?

Kaqusha Jashari - Tha se në parim e përkrah Raportin. Pyeti a ka Inspektorati i Minerave kompetenca të mjaftueshme? A është e nevojshme të ndërmerret diçka? Kërkoj sqarime për licencat dhe për kushtet. Kompania që merr licencë të hulumtimit a mund të shfrytëzohet edhe për keqpërdorim?

Haki Shatri - Në parim e përkrahu Raportin. Përveç se ishte i interesuar për cilësinë e materialit, që po përdoret për t'i shtruar rrugët, pyeti a ka mundësi të dihet cilësia e materialit, a ka KPMM-ja njoftime të tilla dhe a ka Kosova gurë cilësorë?

Safete Hadergjona - Theksoi se aktivitetet e Inspektoratit janë vënë në pah, mirëpo në Raport nuk ka sqarime për vlerësimin e projekteve dhe për kontrollin e zbatimit. Shtoi se janë sqaruar shumë mirë aktivitetet e Inspektoratit lidhur me eksplozivin, për aksidentet në punë etj. Në Raport është theksuar se shumë kompani të licencuara nuk i plotësojnë kushtet e licencimit, siç janë sasia me e vogël e prodhimit se ajo që është planifikuar dhe mosplotësimi i standardeve mjedisore. A janë ndërmarrë masa në këtë drejtim dhe pse nuk u merren licencat atyre kompanive?

Kryetarja - Ia dha fjalën drejtorit të KPMM-së që t'u përgjigjej pyetjeve të parashtruara nga deputetët.

Azem Rexhaj - drejtor i KPMM-së - I falënderoi deputetët për përkrahjen e Raportit, për pyetjet dhe për komentet. Që në fillim deshi të theksonte edhe një herë se KPMM-ja e kryen punën në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë sektor. Legjislacioni, siç thuhet edhe në Raport, duhet të plotësohet me politika dhe me strategji minerare. Këto dy dokumente, shumë të rëndësishme, duhet të dalin nga Qeveria dhe të miratohen nga Kuvendi. Deri sa nuk ka politika dhe strategji minerare, jemi të detyruar të punojmë rreptësisht sipas ligjeve në fuqi. Kjo jo në secilin rast do të ishte zgjedhja me e mirë. Pastaj iu përgjigj pyetjeve të parashtruara, të deputetes Sala Berisha – Shala: 1. Inspektorati i KPMM-së bën hetimet për të gjitha aksidentet në miniera dhe secilën lëndë nëpërmjet Departamentit Ligjor të KPMM-së e dërgon në Prokurori dhe me këtë përfundon përgjegjësia e Inspektoratit. 2. Aplikacionet e refuzuara janë nga të gjitha kategoritë, duke filluar me rërën, me zhavorrin, me gurë gëlqerorë, si dhe me minerale metalesh për të gjitha ato zona që bien në kundërshtim me zonat e interesit të shpallura nga Qeveria. 3. Pjesa më e madhe e planit të gurorëve të Kosovës, është duke u zbatuar nga KPMM-ja. Që ky plan të jetë i plotfuqishëm duhet të miratohet nga Qeveria dhe Kuvendi. Duhet të theksoj se plani tani ka nevojë të rifreskohet më të dhëna të reja, sepse në të nuk janë përfshirë zonat e tjera të mbrojtura, siç janë: parqet natyrore, monumentet kulturore, monumentet e mbrojtura të Pakos së Ahtisarit etj. 4. Matjet ajrore gjeofizike po përdoren deri në njëfarë mase dhe nëpërmjet tyre, së fundi, janë bërë zgjerimet e zonave të interesit. Disa pjesë të këtyre të dhënave janë në dispozicion edhe të kompanive për zonat që kanë licenca, ndërsa të dhënat gjeofizike për materialet radioaktive ende nuk janë publikuar. Nëse duhet të publikohen, për to duhet të vendosë Qeveria me ndonjë vendim. 5. Laboratori Gjeologjik është kompletuar tani. Ju kemi njoftuar se është vendosur në lokalet e Fakultetit Xehetaro-Metalurgjik në Mitrovicë. Funksionimi i tij do të rregullohet me një marrëveshje ndërmjet FXM-së dhe KPMM-se. KPMM-ja do ta administrojë, ndërsa Fakulteti do të ketë mundësi ta përdorë për nevoja shkencore dhe për

praktikë të studentëve. 6. Moratoriumi për lëshimin e licencave për mineralet metalike është marrë parasysh dhe nga KPMM-ja. Nuk është lëshuar asnjë licencë për këto minerale pa u përmbushur vendimi i Qeverisë për shpalljen e zonave me interes të veçantë. Pas shpalljes së këtij vendimi, siç thashë edhe me parë, kemi vazhduar procesimin e kërkesave për licenca. Të gjitha kërkesat që kanë rënë ndesh me këto zona, janë refuzuar. 7. Në Licencën e Drazhnjës janë duke vazhduar hulumtimet. Kosovo Resources LLC është tani për tani ndër kompanitë më serioze të hulumtimit në Kosovë. Sa i përket rregullsisë së licencimit, kjo lëndë është audituar nga auditorët ndërkombëtarë me kërkesë të Kuvendit dhe të Zyrës së Auditorit Gjeneral. Të dy raportet janë shumë të qarta meqë licencimi, kur u dhanë licencat, ishte në përputhje të plotë me ligjet në fuqi. 8. Licencat e Ferronikelit nuk bien ndesh me zonat e interesit të shpallura nga Qeveria. 9. MEM-i mund t'i bëjë strategjinë dhe politikat në bazë të Rregullores 2005/15. Mungesa e ligjit të minierave nuk është pengesë për hartimin e strategjisë së minierave dhe të politikave minerare. 10. Në vitin e kaluar kemi përfunduar hartimin e udhëzimit për tantiema, si dhe listën e re të tantiemave, e cila parasheh që për mineralet metalike të bëhet një rritje rreth 100% të tantiemës. Këtë listë Bordi e ka miratuar, mirëpo ndërkohë kemi pasur rënie të madhe të çmimeve të metaleve në bursën botërore. Për këtë MEM-i kërkoi nga KPMM-ja ta ndalte hyrjen në fuqi të kësaj liste të re, deri sa të kalojë kriza ekonomike. Bordi e shqyrtoi këtë kërkesë dhe mori vendim ta ndalonte hyrjen në fuqi të listës së re për afat të pacaktuar. 10. Ferronikeli i ka paguar tantiemat për vitin 2007, ndërsa për vitin 2008 ende nuk i ka paguar, sepse ka pasur paqartësi në kalkulim të tantiemës dhe në llogaritje të sasisë së xehes. 11. Operimet ilegale bëheshin shumica rreth brigjeve të lumenjve dhe në ato zona, në të cilat mund të merreshin gurë pa përdorimin e eksplozivëve. Këto operime nuk janë pasojë e vonesës së licencimit, por për shkak se kanë treg të sigurt dhe për shkak se Bordi vazhdimisht merrte vendime t'i stimulonte kompanitë ilegale që të licencoheshin. Për këtë arsye kemi edhe një numër të madh të licencave të dhëna me kusht.

Përgjigjet e pyetjeve të deputetes Kaqusha Jashari: 1. Inspektorati i Minierave mjerisht nuk ka kompetenca të mjaftueshme ekzekutive, mirëpo me projektligjin e ri të minierave do t'i jepen kompetenca më të mëdha. 2. Licencat e dhëna me kushte janë bërë më qëllim që kompanive t'u tregohet se ato mund të licencohen, nëse i plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligj. Ndër kushtet që parashihen për kompanitë janë: ta bëjnë pagesën e detyrimeve paraprake të operimeve ilegale të mëhershme, ta paraqesin pëlqimin mjedisor, ta paraqesin pëlqimin komunal etj. 3. Kompania që merr licencë të hulumtimit nuk ka mundësi ta shfrytëzojë atë për eksport në emër të hulumtimit, sepse nuk i lejohet as minimumi i eksportimit. Për eksport duhet të marrë leje të veçantë dhe mund të eksportojë vetëm sa për mostra.

Përgjigjet e pyetjeve të z. Haki Shatri: Sa i përket cilësisë së materialit, KPMM-ja ka njoftime për secilën kompani të licencuar, sepse ato detyrohen t'i paraqesin rezultatet e analizave. Materiali që është duke u përdorur, është kryesisht ilegal dhe i cilësisë së dobët, sepse merret drejtpërsëdrejti nga zonat ku nuk ka nevojë të përdoret eksplozivi. Inspektorati i KPMM-së vazhdimisht i identifikonte këta operues, mirëpo në zbatimin e punimeve po dështon kontrolli. Prandaj ata kanë mundësi ta plasojnë këtë material ilegal edhe me cilësi të dobët.

Përgjigjet e pyetjeve të znj. Safete Hadergjonaj: 1. Inspektorati, para licencimit, i bën vlerësimin e projekteve të xehetarisë dhe krahasimin e tyre me zonën e kërkesës. Po ashtu

e harton një raport, i cili i dërgohet Bordit për secilën kërkesë. Sa i përket kontrollit të zbatimit, kjo bëhet vazhdimisht dhe merren masa sipas nevojës. 2. Është e vërtetë se shumë kompani nuk prodhojnë në përputhje me planifikimin dhe nuk i plotësojnë standardet mjedisore. KPMM-ja, të gjitha këtyre kompanive, ka mundësi t'ua marrë licencat. Meqë nuk mund të ndalen operuesit ilegalë, ndalimi për kompanitë e licencuara nuk do të ishte veprim i qëlluar, sepse këta të paktën i shlyejnë detyrimet ndaj shtetit. Premtoi se ndalimi i tyre mund të bëhet menjëherë pasi të ndalohen ilegalët.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

- I. Miratohet në parim Raporti i KPMM-së për vitin 2008

dhe këtë

REKOMANDIM

- I. Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës ta procedojë për shqyrtim dhe miratim Raportin e KPMM-së për vitin 2008.

V. Të ndryshme **Çështje vijuese**

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që në mbledhjen e radhës pikë e rendit të ditës të jetë shqyrtimi i Raportit vjetor të ZRRE - së.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00.

Kryetare e Komisionit

Myzejene Selmani